



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIJËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIJËS

Nr. 7925/11 Prot.

Tiranë, më 18.11.2021

Lënda: Njoftim për fillim procedurash Revokimi të Lejes Minerare të Shfrytëzimi Nr.809
datë 04.10.2004.

Drejtuar: SHOQËRISË “TEODORI” SHPK
Rruga "Niko Avrami", Shtëpi private pranë Pallati Nr.17, Tiranë.

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “TEODORI” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.809, datë 04.10.2004, për mineral kromi, në objektin “Gal.1,4, Zona mes profileve I-IV”, Ternovë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.3970, datë 01.11.2021 (Nr.7925 Prot. MIE, datë 04.11.2021), është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.809, datë 04.10.2004, për mineral kromi, në objektin “Gal.1,4, Zona mes profileve I-IV”, Ternovë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, **sepse në objekt nuk punohet për më shumë se një vit kalendarik, si dhe nuk keni miratuar Programin Vjetor të Punës në AKBN.**

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014, datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.809, datë 04.10.2004,**

për mineral kromi, në objektin “Gal.1,4, Zona mes profileve I-IV”, Ternovë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, që shoqëria Juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit **Nr.809, datë 04.10.2004, për mineral kromi, në objektin “Gal.1,4, Zona mes profileve I-IV”, Ternovë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.**

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

